

**AKT THEMELIMI DHE STATUT "004"**

---

**AKTI I THEMELIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR**

**"004"**

---

**Tirane, 2024**

# AKT THEMELIMI DHE STATUT "004"

## AKTI I THEMELIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "004"

### KREU I

EMRI I SHOQËRISË, THEMELIMI, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

#### Neni 1

##### Emri

1.1 Sot, datë 17/07/2024 krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emri i së cilës është "004", në vijim e referuar shkurt si "Shoqëria".

#### Neni 2

##### Themelimi

2.1 Shoqëria themelohet bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me këtë Akt Themelimi dhe me Statutin e saj.

#### Neni 3

##### Selia

3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. "Andrea Kushi, Kompleksi Turdiu, Kati I".

3.2 Shoqëria mund të hap dhe të mbaj zyra dhe/ose të kryej aktivitete në vende të ndryshme, brenda Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### Neni 5

##### Objekti

5.1 Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin si më poshtë vijon:  
"Bar-kafe. Servis dhe shit-blerje makinash."

5.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryej cdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

### KREU II

ORTAKËT, KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE

# AKT THEMELIMI DHE STATUT "004"

## Neni 6 Ortakët

6.1 Ortaku dhe themeluesi i shoqërisë është:

a. Eltjon Frroku, zotëron një kuote në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej 100'000 (njëqind mijë) Lekë, të cilat përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

## Neni 7 Kapitali Themeltar

7.1 Kapitali Themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100'000 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë, me vlerë sipas nenit 6 më sipër.

7.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute të para, plotësisht të nënshkruara dhe paguara dhe zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë sipas Nenit 6 të këtij Akti Themelimi.

## Neni 8 Kalimi i Kuotave

8.1 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë sipas parashikimeve statutore, janë lirisht të transferueshme tek cdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet cdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji dhe/ose statutit.

## KREU III ASAMBLEJA E PERGJITHSHME, ADMINISTRIMI, LIGJI I ZBATUESHEM

### Neni 9 Asambleja e përgjithshme

9.1 Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar në vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit/ëve kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit, etj., sikurse parashikohet në Statut dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

### Neni 10 Administrimi i Shoqërisë

10.1 Administratori/ët i/e parë të Shoqërisë janë:

Eltjon Frroku, shtetas shqiptarë lindur më 03/06/1988 në Fushe Arrez, i pajisur nr. Personal 180603082G me adresë në Rrugën "Andrea Kushi", Tiranë.

10.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë riemërimi.

Administratorët emërohen dhe shkarkohen nga detyra, në cdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

### Neni 11 Ligji i Zbatueshëm

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **AKT THEMELIMI DHE STATUT "004"**

**11.2** Cdo konflikt që mund të lind mes ortakëve të Shoqërisë në lidhje me, ose si rrjedhojë e këtij akti themelimi do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar në Tiranë, sot më 17/07/2024

**ORTAKU THEMELUES**

**Eltjon FRROKU**

*Eltjon Frroku*

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and lines, positioned below the printed name.